

**Vendim nr. 9, datë 11.02.2026**

**(V-9/26)**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fiona Papajorgji, Kryetare, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimimi, Marjana Semini, Asim Vokshi, Marsida Xhaferllari, anëtarë, me sekretare Anjeza Puka, në datën 03.02.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve kërkesën nr. 7 (E) 2025 të Regjistrisë Themeltar, që u përket:

**KËRKUES:** **ENDRI KOTHERJA**

**SUBJEKT I INTERESUAR:**

**AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT**, përfaqësuar nga Valbona Legisi dhe Irma Qosja, me autorizim.

**OBJEKTI:**

**Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-5435(363), datë 23.09.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

**Dërgimi i çështjes për shqyrtim në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.**

**BAZA LIGJORE:**

**Nenet 4, 17, pika 2, 18, pika 1, 33, pika 1, 41, pika 1, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; neni 27 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoji relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuarit Endri Kotherja (*kërkuari*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Kërkuari ka ushtruar detyrën e avokatit të shtetit, në periudhën 2009-2013, në pozicione të ndryshme. Në muajin shkurt të vitit 2012 Avokati i Përgjithshëm i Shtetit i ka dhënë kërkuarit tri herë masën disiplinore të vërejtjes me paralajmërim, ndërsa në datën 16.05.2013 e ka shkarkuar atë nga detyra.

2. Duke mos qenë dakord me masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, kërkuari ka ngritur padi në gjykatë, me objekt pavlefshmërinë e urdhrin të shkarkimit, kthimin në vendin e mëparshëm të punës, pagimin e pagës deri në kthimin në detyrë dhe pavlefshmërinë absolute të të tria masave të tjera disiplinore. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë (së cilës i janë kaluar aktet për kompetencë lëndore nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me vendimin e datës 26.12.2013), me vendimin nr. 3665, datë 30.06.2014, ka vendosur pranimin e padisë. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit ka paraqitur apel.

3. Në datën 18.07.2014 Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka konstatuar se apeli i paraqitur kishte të meta që lidheshin me mungesën e aktit të përfaqësimit të nënshkruesit të apelit dhe me mospërputhjen e të dhënave të vendimit të apeluar, ndaj ka caktuar afat për plotësimin e të metave deri në datën 25.07.2014. Pasi ka konstatuar se të metat nuk ishin plotësuar, ajo gjykatë, në datën 25.07.2014, ka vendosur kthimin e apelit së bashku me aktet, duke vënë në dukje se vetë apeli ishte depozituar në gjykatë në datën 17.07.2014 me anë të shërbimit postar dhe se në zarf shënohej data 16.07.2014.

4. Mbi bazën e ankimit të veçantë të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 328, datë 23.02.2015, ka vendosur ndryshimin e vendimit të datës 25.07.2014 dhe pranimin për shqyrtim të apelit të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit kundër vendimit të themelit të çështjes, duke urdhëruar dërgimin e dosjes për veprime administrative në gjykatën e shkallës së parë. Gjykata e apelit ka arsyetuar se: (i) në shkelje të nenit 46, pika 2, të ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*Ligji për Gjykatat Administrative*), gjykata e shkallës së parë *de facto* i ka caktuar apeluesit një afat më të shkurtër se

5 ditë për plotësimin e të metave, duke mos mbajtur në konsideratë se afati fillonte të llogaritej nga dita e komunikimit të vendimit; (ii) të metat ishin plotësuar nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit në datën 24.07.2014, pra brenda afatit të caktuar.

5. Kërkuesi ka paraqitur rekurs, por Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2017-1017, datë 29.06.2017, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin e kufizuar se rekursi nuk përmbante shkaqet e parashikuara nga ligji.

6. Në vijim, kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata), duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve të gjykatës së apelit dhe të Gjykatës së Lartë, me të cilat ishte pranuar se të metat e apelit ishin plotësuar në afat nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, duke ngritur, ndër të tjera, pretendimin për cenimin e parimeve të sigurisë juridike dhe të barazisë përpara ligjit, si dhe së drejtës për proces të rregullt ligjor. Sipas kërkuesit, apeli i Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit ishte paraqitur jo vetëm me të meta që lidheshin me mungesën e autorizimit të nënshkruesit, por edhe jashtë afatit ligjor 15-ditor. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 290, datë 20.12.2017, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me arsyetimin se për çështjen e kërkuesit nuk kishte një vendim përfundimtar, ndaj nuk plotësohej kriteri i shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

7. Ndërkohë, çështja e themelit është dërguar për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila, në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. 251, datë 04.04.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë për pranimin e padisë. Lidhur me pretendimin e kërkuesit se apeli ishte paraqitur jashtë afatit ligjor, gjykata e apelit ka arsyetuar se vendimi i ankimuar ishte shpallur në datën 30.06.2014 në prani të palëve ndërgjyqëse, ndërsa apeli ishte depozituar nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit nëpërmjet shërbimit postar në sekretarinë gjyqësore në datën 17.07.2014, pra brenda afatit të përcaktuar nga nenet 443, paragrafi i parë, dhe 444 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), si dhe referuar vendimeve gjyqësore të gjykatës së apelit dhe të Gjykatës së Lartë që kishin pranuar ankimin e veçantë ndaj kthimit të apelit nga gjykata e shkallës së parë.

8. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit ka paraqitur rekurs, duke kërkuar njëkohësisht edhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë. Kërkuesi ka paraqitur kundërrekurs.

9. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-3151, datë 25.07.2023, në dhomën e këshillimit, ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit. Në vijim, Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar çështjen në seancë gjyqësore me pjesëmarrjen e palëve dhe me vendimin nr. 00-2024-5435 (363), datë 23.09.2024, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe kthimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e shkallës së dytë. Sipas Gjykatës së Lartë, gjykatat e faktit, duke zbatuar edhe parimin e barrës së provës të gjykimit administrativ, duhej të

merrnin prova dhe të verifikonin respektimin e afatit ligjor nga kërkuesi për ngritjen e pretendimeve ndaj tri vërejtjeve me paralajmërim, të cilat ishin shqyrtuar dhe anuluar nga ato gjykata, duke arritur më pas në përfundimin se masa e shkarkimit nga detyra nuk ishte proporcionale. Ndërsa për pretendimin e kërkuesit, të parashtruar në kundërrekurs, se apeli ishte paraqitur nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit jashtë afatit ligjor, Gjykata e Lartë nuk është shprehur.

10. Në datën 07.04.2025 kërkuesi i është drejtuar përsëri Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Kolegji i Gjykatës në datën 27.05.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

## II

### Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

11. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se nga vendimi i Gjykatës së Lartë i janë cenuar:

11.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

11.1.1. *Parimi i gjykatës së caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë duhet të kishte vendosur mospranimin e rekursit. Ajo nuk kishte juridiksion për të shqyrtuar pretendimet e ngritura në recurs nga pala e paditur, pasi ato nuk ishin ngritur në gjykimin në shkallë të parë, ndaj kishin rënë në dekadencë. Gjykata e Lartë nuk përcaktoi se cilat çështje të ligjit do të viheshin në diskutim në seancë, nëse ato do të trajtoheshin kryesisht apo ishte pranuar kërkesa e vet kërkuesit për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore.

11.1.2. *Parimi i barazisë së armëve i lidhur me të drejtën e mbrojtjes*, pasi kryesuesi i kolegjit të Gjykatës së Lartë i ka ndërprerë fjalën kërkuesit disa herë gjatë seancës për çështje me natyrë kushtetuese, siç është edhe ajo e apelit e paraqitur jashtë afatit.

11.1.3. *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor i lidhur me të drejtën e aksesit*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka dhënë përgjigje për pretendimin me natyrë kushtetuese të ngritur në kundërrekurs dhe në parashtrime, që kishin të bënin me paraqitjen e apelit jashtë afatit ligjor.

11.2. *Parimi i sigurisë juridike*, i garantuar nga neni 4 i Kushtetutës, pasi vendimi i gjykatës së shkallës së parë ishte i formës së prerë dhe gjë e gjykuar. Apeli i Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit është depozituar në datën 15.07.2014, pra 1 ditë jashtë afatit ligjor 15-ditor.

11.3. *Parimi i barazisë përpara ligjit*, i garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi Gjykata e Lartë nuk ka marrë parasysh jurisprudencën e Gjykatës dhe të vet asaj në disa vendime për parimin *res judicata* e për rrjedhojë, është favorizuar organi publik.

12. **Subjekti i interesuar, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

12.1. Kërkuesi nuk ka *shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë ka vendosur kthimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e apelit, ndaj pretendimet duhet t'i paraqiste përpara asaj gjykate.

12.2. Pretendimi për cenimin e *së drejtës për një proces të rregullt ligjor* nuk qëndron, pasi:

12.2.1. Gjykata e Lartë, në respektim të *parimit të gjykatës së caktuar me ligj*, pra brenda kompetencave ligjore të saj, e ka kthyer çështjen për rigjykim, duke dhënë udhëzimet përkatëse, në mënyrë që gjykata e apelit të arrijë në një konkluzion të plotë për çështjen.

12.2.2. Kërkuesi është dëgjuar në seancë për pretendimet e tij, duke i pasur të gjitha mundësitë për t'u mbrojtur dhe për të paraqitur qëndrimin e tij, ndaj pretendimi për cenimin e *parimit të barazisë së armëve* të lidhur me *të drejtën e mbrojtjes* është i pabazuar.

12.2.3. Vendimi i Gjykatës së Lartë i plotëson kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e vendimit, për rrjedhojë nuk qëndron pretendimi për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* të lidhur me *të drejtën e aksesit*.

12.3. Pretendimi për cenimin e *parimit të sigurisë juridike* i lidhur me parimin *res judicata* nuk qëndron. Apeli është paraqitur brenda afatit ligjor dhe ky fakt është shqyrtuar nga gjykata e apelit, ku është paraqitur si provë kopja e librit të postës. Gjykata e apelit ka arritur në konkluzionin se çështja e pranueshmërisë së apelit ishte trajtuar në rrugë gjyqësore nga të tria shkallët e gjyqësorit, duke rrëzuar pretendimin e kërkuesit.

12.4. Pretendimi për cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit* është i pabazuar. Fakti që gjykatat e zakonshme kanë vendosur ndryshe në një rast të ngjashëm, në vetvete nuk justifikon apriori pretendimin e kërkuesit, pasi mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate, për sa kohë që çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj.

### III

#### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

##### A. Për kërkesën paraprake në gjykimin kushtetues

13. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me kërkesë paraprake, e cila lidhet me kohën e paraqitjes së prapësimeve nga subjekti i interesuar. Ai ka pretenduar se, ndonëse Gjykata, sipas pikës 6 të nenit 38 të Ligjit Organik të saj, kishte caktuar afatin deri në datën 01.07.2025, parashtrimet e subjektit të interesuar janë paraqitur në datën 03.07.2025, ndaj ato nuk duhet të merren në shqyrtim.

14. Gjykata konstaton se subjekti i interesuar është thirrur nga Gjykata për të marrë pjesë në gjykimin kushtetues, duke vlerësuar se ishte i rëndësishëm dëgjimi i tij në cilësinë e palës së paditur në procesin gjyqësor të kundërshtuar. Ai është njoftuar me shkrim në datën 03.06.2025 për paraqitjen e prapësimeve me shkrim brenda datës 01.07.2025. Prapësimet janë postuar në datën 01.07.2025 (sipas vulës së shërbimit postar) dhe kanë mbërritur në Gjykatë në datën 03.07.2025. Duke mbajtur parasysh datën e postimit të tyre, Gjykata, bazuar në fjalinë e fundit të pikës 5 të nenit 15 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, arrin në përfundimin se parashtrimet konsiderohen të paraqitura në afat, për rrjedhojë kërkesa paraprake e kërkuesit është e pabazuar dhe nuk pranohet.

##### B. Për legjitimitimin e kërkuesit

15. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

16. Në këndvështrim të kriterëve paraprake, Gjykata çmon se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në çështjen ku është vendosur për marrëdhënien e punësimit të tij, për rrjedhojë justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

17. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të

ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Cenimi i të drejtave themelore mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apeli dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të tyre (*shih vendimet nr. 24, datë 27.04.2023; nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në rastin konkret, Gjykata vëren se objekti i ankimit kushtetues individual është shfuqizimi i vendimit të Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur dërgimin e çështjes për rishqyrtim në gjykatën e apelit. Pretendimi kryesor i kërkuarit lidhet me cenimin e parimit të sigurisë juridike në drejtim të gjësë së gjykuar, që ka të bëjë me faktin se gjykata e apelit ka marrë në shqyrtim apelin e paraqitur jashtë afatit ligjor nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit.

19. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se, si rregull, vendimet për kthimin e çështjes për rigjykim nuk konsiderohen përfundimtare, për efektet e gjykimit kushtetues, pasi ato nuk vendosin në mënyrë përfundimtare për themelin e çështjes (*shih vendimet nr. 39, datë 06.07.2016; nr. 48, datë 06.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Përjashtimisht, këto lloj vendimesh i nënshtrohen kontrollit kushtetues kur kërkuari pretendon shkeljen e parimit të sigurisë juridike në drejtim të gjësë së gjykuar, bazuar në faktin se gjykatat e zakonshme kanë marrë në shqyrtim ankimin jashtë afatit ligjor, pasi pasoja e kësaj shkeljeje është e tillë që nuk mund të riparohet gjatë rigjykimit të çështjes, pra në procesin gjyqësor që është duke u zhvilluar në juridiksionin e zakonshëm (*shih vendimin nr. 59, datë 14.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Mbi bazën e këtij standardi, duke mbajtur në konsideratë edhe faktin që ankimi kushtetues individual i kërkuarit i vitit 2017 nuk u pranua me arsyetimin se për çështjen e tij nuk kishte ende vendim përfundimtar (*shih supra paragrafin 6*), çështja e kërkuarit kaloi për shqyrtim në seancë plenare për të zhvilluar më tej standardet e kriterit të shterimit të mjeteve juridike të lidhur me rolin subsidiar të gjykatave të zakonshme.

21. Gjykata ka pohuar se qëllimi i kriterit të shterimit të mjeteve juridike në dispozicion është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në të (*shih vendimin nr. 24, datë 27.04.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Raporti ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur shqyrtohen ankime kushtetuese individuale, në bazë të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (*shih vendimet nr. 52, datë 02.12.2013; nr. 36, datë*

25.07.2013; nr. 58, datë 24.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese). Sistemi gjyqësor është një sistem korrigjues subsidiar, i cili, nga mënyra sesi është ndërtuar dhe funksionon, u përgjigjet të gjitha pretendimeve për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore, dhe individi ka mundësinë që në çdo hallkë, fazë ose shkallë të procesit të ngrejë pretendime konkrete (shih vendimin nr. 1, datë 26.01.2021 të Gjykatës Kushtetuese).

22. Gjykata thekson se ana tjetër e parimit të subsidiaritetit lidhet me nevojën për t'i identifikuar dhe riparuar sa më shpejt shkeljen e të drejtave themelore, pra sapo ato bëhen të ditura për gjykatat e zakonshme. Këto të fundit, duke pasur kompetencën për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve ligjore të qytetarëve, janë në pozicionin e duhur për të filluar dhe, nëse është e nevojshme, për t'i dhënë forcë detyruese interpretimit kushtetues që mbron të drejtat themelore.

23. Nën dritën e parimit të subsidiaritetit, në rastin konkret, Gjykata vlerëson se për të verifikuar nëse ka shkelje të parimit të sigurisë juridike është e rëndësishme të përcaktohet se, në fazën ku gjendet procesi gjyqësor i kërkuarit, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë mbajtur ose jo qëndrim përfundimtar për pretendimin se apeli i Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit ishte paraqitur jashtë afatit ligjor.

24. Gjykata vëren se gjatë gjykimit të çështjes në gjykatën e shkallës së dytë, kërkuari ka prapësuar afatin e paraqitjes së apelit të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, duke depozituar edhe prova dokumentare për datën e postimit përtej 15 ditëve. Gjykata Administrative e Apelit në vendimin e vitit 2023 nuk e pranoi prapësimin e kërkuarit, duke arsyetuar në mënyrë të paqartë përlllogaritjen e afatit dhe duke vënë në dukje se vendimi i ankimuar ishte shpallur në datën 30.06.2014 në prani të palëve ndërgjyqëse, ndërsa apeli ishte depozituar nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit nëpërmjet shërbimit postar pranë sekretarisë gjyqësore në datën 17.07.2014. Në nxjerrjen e këtij konkluzioni, gjykata e apelit u është referuar neneve 443, paragrafi i parë, dhe 444 të KPC-së së kohës, të cilat në përmbajtje parashikonin se afati i apelit ishte 15 ditë, i cili fillonte të llogaritej nga e nesërmja e shpalljes së vendimit. Po kështu, gjykata e apelit u është referuar vendimeve gjyqësore të vet asaj gjykate dhe të Gjykatës së Lartë që kishin pranuar ankimin e veçantë ndaj kthimit të apelit nga gjykata e shkallës së parë, ndonëse në ato vendime nuk kishte arsyetim ose konkluzion për afatin e paraqitjes së apelit nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit. Në vijim, Gjykata e Lartë mori në shqyrtim rekursin e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit dhe u shpreh për shkaqet e ngritura në të, por pa dhënë ndonjë përgjigje për pretendimin e kërkuarit, të ngritur nga ai në aktin e kundërrekursit, madje edhe në seancën gjyqësore. Me fjalë të tjera, gjykatat e zakonshme nuk kanë mbajtur qëndrim përfundimtar për pretendimin e kërkuarit se apeli i Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit ishte paraqitur jashtë afatit ligjor, që, sipas tij, cenon parimin e sigurisë juridike.

25. Çështja e kërkuarit aktualisht është duke u shqyrtuar në gjykatën e shkallës së dytë nga Gjykata Administrative e Apelit, për shkak të kthimit për rigjykim të urdhëruar nga Gjykata e Lartë. Duke iu referuar kërkesave ligjore procedurale, gjykata e apelit, e cila krahas detyrimit ligjor për të zbatuar udhëzimet dhe konkluzionet e Gjykatës së Lartë, duhet të luajë rolin e saj kushtetues subsidiar për respektimin e të drejtave themelore, duke shqyrtuar dhe duke i dhënë përgjigje të shprehur pretendimit me natyrë kushtetuese të kërkuarit për afatin e paraqitjes së apelit nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit. Në këtë mënyrë, Gjykata arrin në përfundimin se shkeljet e pretenduara mund dhe duhet të marrin përgjigje gjatë rigjykimit të çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit, që do të thotë se vendimi i Gjykatës së Lartë i kundërshtuar në ankimin kushtetues individual nuk është përfundimtar për qëllime të kontrollit kushtetues.

26. Për sa më lart, Gjykata thekson se vendimet gjyqësore për kthimin e çështjes për rigjykim i nënshtrohen kontrollit kushtetues në mënyrë përjashtimore. Këto raste përjashtimore kanë të bëjnë me pretendimin e kërkuarit për shkeljen e parimit të sigurisë juridike në drejtim të gjësë së gjykuar të lidhur domosdoshmërisht me faktin që gjykatat e juridiksionit të zakonshëm të kenë mbajtur qëndrim të shprehur përfundimtar për çështjen e faktit dhe/ose të ligjit, që ka diktuar ecurinë e çështjes.

27. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkuari ka ende mjete juridike efektive në dispozicion, sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa rrëzohet.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

### **V E N D O S I:**

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

**Marrë më 11.02.2026**

**Shpallur më 09.03.2026**